



Munich Personal RePEc Archive

Financial statements analysis: Users of financial ratios

Govori, Fadil

Institute for Finance and Management - IFM

21 December 2011

Online at <https://mpra.ub.uni-muenchen.de/46707/>

MPRA Paper No. 46707, posted 09 May 2013 07:21 UTC

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË BIZNES - PEJË

Analiza e pasqyrave financiare: Përdoruesit e treguesve financiarë
Financial statements analysis: Users of financial ratios

Fadil Govori
govorif@gmail.com

Prishtinë
Prill, 2012

Financial statements analysis: Users of financial ratios

Abstract

Understanding and the interpretation of financial statements is an important factor for economic entities, for making the right decisions. Nowadays, more and more is noticed the general tendency of the harmonization of the Directive IV of the European Committee with International Financial Reporting Standards.

Different groups of people need information about the business activities of each business. In this paper we address ways of designing and drafting of the financial statements and their contextual interpretation in accordance with IAS and IFRS. Also we identify some of stakeholders who are the main users of the information arising from these financial statements and their importance in decision making.

Key words: Financial analysis, financial statement, financial indicators, financial reports, financial reporting, accounting standards, international accounting standards, stakeholders, decision making.

JEL Classification: M, M4, M40, M41, M42, M48, M49, G3, G30, G31, G32

Analiza e pasqyrave financiare: Përdoruesit e treguesve financiarë

Fadil Govori
Universiteti i Prishtinës / FSHAB Pejë, Kosovë
govorif@gmail.com

Abstrakt:

Kuptimi dhe interpretimi i pasqyrave financiare paraqet një faktor të rëndësishëm për subjekte ekonomike, në marrjen e vendimeve të drejta. Sot çdo herë e më shumë po vihet re një tendencë e përgjithshme, harmonizimi i Direktivës IV të Komitetit Europian me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Grupe të ndrueshme njerëzish kanë nevojë për informacione rreth aktiviteteve afariste të secilit biznes. Në këtë punim do të trajtojmë mënyren e sajimit dhe interpretimit të pasqyrave kryesore financiare, në harmoni me SNK-të dhe SNRF-të, kush janë shfrytëzuesit apo përdoruesit kryesor të informatave që dalin nga këto pasqyra financiare dhe rëndësinë e tyre në vendimmarrje.

Terma kyç: Analizë financiare, pasqyrë financiare, tregues financiar, raportet financiare, raportim financiar, standarde të kontabilitetit, standarde ndërkombëtare të kontabilitetit.

Klasifikimi JEL: M, M4, M40, M41, M42, M48, M49, G3, G30, G31, G32

Përmbajtja

	Abstract	2
	Abstrakt	3
	Përmbajtja	4
1	Hyrje	5
2	Përdoruesit e pasqyrave financiare	6
3	Bilanci i gjendjes	8
4	Pasqyra e të ardhurave	10
5	Pasqyra e rrjedhjeve të arkës	11
5.1	Aktivitetet operacionale	12
5.2	Aktivitetet investuese	12
5.3	Aktivitetet e financimit	13
6	Treguesit e pasqyrave financiare	14
7	Konkluzion	17
	Referenca	18

Analiza e pasqyrave financiare: Përdoruesit e treguesve financiarë

1. Hyrje

Analiza e pasqyrave financiare është një proces gjykimi që synon të vlerësojë pozicionin financiar të kaluar dhe atë të tashmën në një kompani. Objektivi parësor i saj është përcaktimi, parashikimi dhe vlerësimi më i mirë i kushtve ekonomike dhe performances në të ardhmen.

Përpyekjet për të bërë një analizë financiare i shohim në çdo organizatë të pajisur me autonomi financiare, siç janë: shoqëritë tregtare, firmat, shoqatat e ndryeshme, institucionet publike, ato financiare, etj.

Analiza e pasqyrave financiare është *një metodë e krahasimit, gjykimit ose e vlerësimit* të gjendjes së vlerave të pjesëve të catuara të bilanceve, në bazë të cilave merrën vendimet e rëndësishme. Pra, analiza financiare, është një *analizë e bilanceve* për të kaluarën, të tashmën dhe të ardhmën e ndërmarrjes. Vlerat e pozicioneve të bilanceve veç e veç nuk kanë rëndësi të larta analitike. Por, nëse ato i krahasojmë me vlerat e pozicioneve të tjera të bilancit atëherë *vlera krahasuese e tyre rritet*. Për shembull, nëse i pjestojmë të hyrat nga shitja me numrin e blerësve, atëherë fitojmë një tregues mbi xhiron për një të punësuar që është një tregues i rëndësishëm mbi produktivitetin e ndërmarrjes.

*Objektivi i pasqyrave financiare është dhënja e informacioneve rreth **pozicionit financiar, performancës financiare dhe ndryshimeve në pozicionin financiar** të një entiteti, të cilat janë të përdorshme prej një game të gjerë përdorusish në marrjen e vendimeve të tyre ekonomike.*¹

Pasqyrat financiare paraqesin fazën përfundimtare të procedimit të të dhënave të kontabilitetit dhe paraqiten si bartës të informative kontabile.

Pasqyrat financiare janë prezentime financiare të strukturuar të gjendjes financiare dhe transaksioneve të kryera nga ana e ndërmarrjes. Sipas SNK/IAS, pasqyrat financiare sigurojnë informacion për:

- Mjetet
- Detyrimet
- Kryegjënë
- Të hyrat dhe të dalat
- Rrjedhjen e parasë

¹ Lewis, Richard & Pendrill David; *Advanced Financial Accounting*, seventh edition, 2004. f. 76-95

Pasqyrat financiare janë të nevojshme, sepse ato ndihmojnë përdoruesit e ndryshmëm të tyre, të marrin vendime ekonomike të drejta, si dhe të kuptojnë raportimin financiar me qëllim që të përmirësojnë vendimmarrjen.²

2. Përdoruesit e pasqyrave financiare

Grupe të ndryshme njerëzish kanë nevojë për informacione rreth aktiviteteve afariste të secilit biznes.³

- (a) **Menaxherët e kompanisë** të caktuar nga pronarët e kompanisë për të mbikëqyrur aktivitetet e përditshme të kompanisë. Atyre iu nevojiten informacione rreth situatës financiare të kompanisë – mënyrës se si është tani dhe se si pritet të jetë në të ardhmen. Kjo iu mundëson atyre arritjen e efikasitetit në biznes dhe marrjen e vendimeve efektive.
- (b) **Aksionarëve të kompanisë**, pra pronarëve të kompanisë, të cilët duan ta dinë se sa mirë po përmbush menaxhmenti detyrat e veta. Ata duan ta dinë se sa fitimprurëse janë aktivitetet e kompanisë dhe sa fitim mund të tërheqin prej biznesit për ta përdorur për qëllimet e tyre personale.
- (c) **Personat që punojnë me kompaninë** përfshijnë furnitorët të cilët furnizojnë kompaninë me mallra me kredi (afat pagese) dhe klientët të cilët blejnë mallra ose shërbime të prodhuara nga kompania. **Furnitorët** kërkojnë të dijnë rreth afëtsisë së kompanisë për të paguar borxhet e veta; **klientët** kërkojnë të dijnë nëse kompania është një vend i sigurtë prej nga furnizohen dhe nëse është ose jo në rrezik të mbyllet.
- (d) **Personat që financojnë kompaninë** mund të jenë një bankë e cila i lejon kompanisë të ketë një overdraft ose që i siguron kreditim afatgjatë duke i garantuar një kredi. Banka dëshiron të sigurohet se kompania është e aftë të ripagujë pagesat e interest dhe bashkë me shumat e marra hua.
- (e) **Autoritetet tatimore** kërkojnë të dijnë rreth fitimeve të biznesit në mënyrë që të vlerësojnë tatimet e pagueshme prej kompanisë, përfshirë këtu Tatimin në vlerën e shtuar e tatime të tjera të shitjes.
- (f) **Punonjësit e kompanisë** duhet të kenë të drejten e marrjes së informacioneve rreth situatës financiare të kompanisë, për arsye se e ardhmja e tyre, karriera dhe shuma monetare pagave dhe rrogave të tyre varet prej kësaj situatë.
- (g) **Analistët dhe këshilltarët financiarë** kanë nevojë për informacione për klientët ose personat që marrin këshilla prej tyre. Për shembull, agjentët e këmbimit të aksioneve kanë nevojë për informacione në mënyrë që të kshillojë personat që duan të investojnë; agjencitë e kreditit duan

² Helfert, Erich A.; *Financial Analysis-Tools and Techniques*, 2001. f. 62-73

³ Horngren Charles, Harrison Walter, Smith Bamber Linda; *Accounting*, Fifth Edition, 2002. f. 57-77

informacione në mënyrë që të këshillojë furnitorët e mundshëm të mallrave të kompanisë; de gazetarët kanë nevojë për informacione për publikun që lexon mediat e tyre.

(h) Qeveritë dhe agjencitë e tyre janë të interesuara për alokimin e burimeve dhe si pasojë për entitetet e biznesit. Ato gjithashtu kërkojnë informacione në mënyrë që të marrin të dhëna për statistika kombëtare.

(i) Publiku i gjerë. Entitetet kanë ndikim mbi elementët e publikut të gjerë në një sërë mënyrash. Për shembull, nëpërmjet krijimit të vendeve të punës dhe përdorimit të furnitorëve vendas ato kontribuojnë në ekonominë vendore. Një faktor tjetër i rëndësishëm është efekti i këtij entiteti mbi ambijentin, për shembull ndikimi mbi ndotjen.

Në çdo analizë të pasqyrave financiare, edhe ajo që ka për objekt rrjedhjet financiare, duhet të ndjek një procedurë të caktuar. Hapat e kësaj procedurë që duhet ndjekur gjatë një analize financiare cilësore janë:

- **Mbledhja dhe formimi** i dokumentacionit kontabël,
- **Klasifikimi** dhe kontimi i të dhënave në librat afarist,
- Hartimi i **raporteve financiare**.

Procesi i kontabilitetit apo sistemi i raportimit financiar, të cilat gjenerojnë informacionin financiar për përdoruesit e jashtëm duhet të përfshijnë ato pasqyra kryesore financiare të cilat janë të domosdoshme për t'u përgaditur dhe raportuar siç specifikohet në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Sipas SNK/IAS 1 një komplet i tillë i pasqyrave përfshinë:⁴

- Bilanci i gjendjes (pasqyra e pozicionit financiar),
- Pasqyra e të ardhurave,
- Pasqyra e rrjedhjeve të arkës (rrjedhjet e parasë së gatshme),
- Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet,
- Politikat e kontabilitetit dhe shënimet shpjeguese.

Në këtë punim ne do t'i trajtojmë kryesisht tre pasqyrat e para, të cilat përndryshe janë ndër raportet më të kërkuara.

Pasqyrat financiare lidhen me njera tjetrën, sepse marrin shifra nga njëra tjetra, p.sh., bilanci i gjendjes merr nga pasqyra e ndryshimit të kapitalit, kapitalin në datën e ndërtimit të bilancit (në fund të periudhës), pasqyra e ndryshimeve në kapital merr nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve shumën e të ardhurës neto të realizuar gjatë periudhës, pasqyra e rrjedhjeve të arkës merr nga pasqyra e lëvizjes së kapitalit investimet dhe tërheqjet e pronarit, etj. Të katër pasqyrat së bashku japin në mënyrë të plotë dhe sistematike informacionin që u nevojitet të tretëve për një ndërmarrje të caktuar, pavarësisht nga madhësia e saj.

⁴ *Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit – SNK/IAS. f. 24-63*

Analiza e pasqyrave financiare është një process kompleks që kërkon dije të thella e të gjithanëshme jo vetëm në fushën e kontabilitetit, por kërkon njohuri të mira në fushën makroekonomike, mikroekonomike, ashtu edhe në fushën e metodave statistikore e matematikore me anën e të cilave maten dhe studiohen nivelet, tendencat dhe lidhjet ndërmjet treguesve të ndryshëm ekonomikë e financiarë e të faktorëve që ndikojnë në ndryshimin e tyre.

Ekzistojnë analizatë ndryshme në varësi të asaj se nga kush bëhen dhe për qafër qëllimi bëhen, kështu kemi analiza horizontale dhe vertikale, analiza të brendëshme dhe të jashtme, analiza statike dhe dinamike, analiza historike dhe të perspektives, etj.

3. Bilanci i gjendjes

Bilanci i gjendjes jep informacion të vlefshëm financiar për një kompani të caktuar, sidomos kur veprimtaria e saj shtrihet prej disa vitesh dhe shqyrtohet bashkërisht me pasqyrat e tjera financiare. Që të mund ta realizojmë këtë objektiv, bilanci i gjendjes duhet të jetë i lexueshëm dhe duhet të dimë ta lexojmë atë. Por, sidoqoftë duhen njohur paraprakisht llogaritë bazë të bilancit, kuptimi i tyre, funksionimi dhe lidhja e secilës llogari me bilancin dhe me pasqyrat tjera financiare.

Bilanci i gjendjes është thjeshtë një listë e të gjitha pasurive që biznesi zotëron dhe të gjitha detyrimeve që ai ka në një datë të caktuar. Mund të shëmbëllet me një fotografi të pozicionit financiar të biznesit në një moment të caktuar. Secilës pasuri dhe detyrim i caktohet një shumë përkatëse monetare. Bilanci i gjendjes në një ndërmarrje jep përgjigje se çfarë kanë investuar pronarët e saj.

Me fjalë tjera bilanci i gjendjes, paraqet një lloj të pasqyrës krahasuese tabelare dyanësore, në njëren anë pasqyrohen të gjitha mjetet dhe në anën tjetër të gjitha burimet e mjeteve me të cilat disponon kompania në një datë të caktuar. Apo thënë ndryshe, bilanci i gjendjes paraqitet në formë të pasqyrës së dyanshme, në anën e majtë – **Aktiv** (ku përfshihen astete të tilla si; toka, ndërtesa, makinat, mjetet monetare, etj), ndërsa në anën e djathtë – **Pasiv** (ku paraqiten detyrimet dhe kapitali i pronarit/ve).⁵

Aktivitet ndahen në aktive afatgjata (ose të qëndrueshme) dhe aktivitet afatshkurta (ose qarkulluese). Në aktive të qëndrueshme hyjnë ato aktive të cilat e kanë afatin e përdorimit më të gjatë se një vit. Aktivitet e qëndrueshme ndahen në: **aktive materiale** dhe **aktive jo materiale**. Në aktive materiale hyjnë: toka, ndërtesat, pajisjet e ndryshme, etj., në aktive jomateriale hyjnë: patenta, licenca, marka tregtare, goodëill, etj. Ndërsa në aktive qarkulluese hyjnë ato aktive të cilat e kanë afatin e përdorimit më të shkurtë se një vit, e ku bëjnë pjesë: paraja e gatshme, depozitat në bankë, llogaritë e arkëtueshme, shpenzimet e parapaguara, inventarët, etj.

Paraqitja e bilancit të gjendjes, sikurse do ta shikojmë më poshtë, mundëson ndër të tjera matjen e kredibilitetit të ndërmarrjes (dmth aftësinë e ndërmarrjes, në një moment të dhënë, për të paguar borgjet). Bilanci i gjendjes lejon gjithashtu edhe analiza të tjera të gjendjes së ndërmarrjes, të cilat do t'i shqyrtojmë në vijim.

⁵ Lewis, Richard & Pendrill David; *Advanced Financial Accounting*, seventh edition, 2004. f. 89-102

BILANCI I GJENDJES
për vitin që përfundon më 31.12.2010

Zërat e Bilancit	2009	2010
PASURIA (AKTIVI)		
<i>Pasuritë qarkulluese:</i>		
Paratë në bankë dhe në dorë	1 803	73 188
Depozitat në bankë	0	0
Llogaritë e arkëtueshme	708 565	940 915
Stoqet	71 480	160 000
Shpenzimet e parapaguara	0	0
Pasurit tjera rrotulluese	0	900
<i>Gjithsej Pasuritë qarkulluese</i>	781 848	1 175 003
<i>Pasuritë e qëndrueshme:</i>		
Toka, ndërtesat dhe pajimet	1 856 911	3 192 060
Pasuritë e huazuara	0	0
Investimet	0	0
Amortizimi	0	0
<i>Gjithsej Pasuritë e qëndrueshme</i>	1 856 911	3 192 060
GJITHSEJ PASURIA (AKTIVI)	2 638 759	4 367 063
DETYRIMET DHE KRYEGJËJA		
(PASIVI)		
<u>DETYRIMET</u>		
<i>Detyrimet afatshkurta</i>		
Llogaritë e pagueshme	50 000	48 791
Shpenzimet e akumuluar	0	0
Huazimet afatshkurta	0	0
Dividendë të pagueshme	0	0
Tatimi i pagueshëm mbi të hyrat	0	0
Detyrimet tjera afatshkurta	0	0
<i>Gjithsej Detyrimet afatshkurta</i>	50 000	48 791
<i>Detyrimet afatgjata</i>		
Huat	0	0
Detyrimet ndaj kapitalit hua	0	0
<i>Gjithsej Detyrimet afatgjata</i>	0	0
<u>KAPITALI DHE REZERVAT (KRYEGJËJA)</u>		
Kapitali i deponuar	2 708 723	2 708 723
Rezervat (Ndihmat, Grandet, Dhuratat kapitale)	0	1 682 522
Fitimi (Humbja) i,e mbetur (Raportues)	(129 438)	46 991
Fitimet (Rezultat) e bartura	9 474	(119 964)
<i>Gjithsej Kryegjëja</i>	2 588 759	4 318 272
GJITHSEJ DETYRIMET DHE KRYEGJËJA	2 638 759	4 367 063

4. Pasqyra e të ardhurave

Pasqyra e të ardhurave është një regjistër i të hyrave të gjenruara dhe shpenzimeve të ndodhura për një periudhë kohore. Kjo pasqyrë tregon nëse biznesi ka pasur më shumë të hyra se sa shpenzime (pra fitim) ose e kundërta (humbje).

Pasqyra e të ardhurave reflekton efektet operative menaxheriale në përmasat e biznesit dhe rezultatin e tyre në fitim apo humbje për pronarët e biznesit gjatë një periudhe të caktuar kohore. Fitimi apo humbja e llogaritur në pasqyrën e të ardhurave rrit apo zvogëlon pasurinë e aksionarit në bilancin e gjendjes.

PASQYRA E TË ARDHURAVE

01.01.2010 – 31.12.2010

Zërat	2009	2010
Të hyrat e përgjithshme	328 850	568 001
Të hyrat nga shitja	291 700	547 837
Të hyrat financiare	37 150	20 164
Shpenzimet e produkteve të shitura	8 000	10 033
Fitimi bruto	320 850	557 968
Shpenzimet e tjera të afarizmit	450 288	499 229
Shpenzimet e kamatës	0	0
Fitimi para tatimit	(129 438)	58 739
Tatimi në fitim	0	11748
Fitimi neto	(129 438)	46 991
Dividenda	0	0
FITIMI I MBAJTUR	(129 438)	46 991

5. Pasqyra e rrjedhjeve të arkës

Pasqyra e rrjedhjeve të arkës duhet të paraqitet si një **pjesë integrale** e pasqyrave financiare të një entiteti. Të gjitha llojet e entiteteve mund të japin informacione të dobishme rreth rrjedhjeve të arkës pasi nevoja për para të gatshme është universale, cilado qoftë natyra e aktiviteteve që gjenerojnë të hyra. Pra **të gjitha entiteteve iu kërkohet me standard (SNK 7) të përpilojnë një pasqyrë të rrjedhjeve të arkës.**⁶

Pasqyra e rrjedhjeve të arkës është një pasqyrë shtesë e dobishme e pasqyrave financiare të një kompanie për arsye se fitimi i kontabilitetit nuk është i vetmi tregues i performancës së kompanisë. Pasqyra e rrjedhjeve të arkës përqendrohet mbi burimet dhe përdorimet e parasë së gatshme dhe është një tregues i rëndësishëm i likuiditetit dhe aftësisë për të paguar të një kompanie.

Pasqyra e rrjedhjes së arkës i ndihmon investitorët dhe kreditorët për të vlerësuar mundësinë për të gjeneruar rrjedhjen positive të parasë në të ardhmen, mundësinë për t'i përmbushur obligimet dhe për të paguar dividendët, qftësinë që të ndikoj në shumën dhe kohën e rrjedhjeve të parave, në mënyrë që t'i përshtaten rrethanave dhe mundësive të ndryshme, arsyeve të ndryshmeve ndërmejt arkëtimeve në para të gatshme dhe pagesave, si dhe aspekte tjera.

Shpeshë argumentohet se 'fitimi' nuk jep gjithmonë një pamje të dobishme ose të kuptimtë të operacioneve të një kompanie. Lexuesit e pasqyrave financiare të një kompanie mund të orientohen gabim **prej shifrave të fitimit të raportuar:**

- (a) Aksionarët mund të besojnë se nëse kompania bën fitime pas tatimeve, për le të themi, 100 000 € atëherë kjo është shuma e cila do të mund të **paguhet si dividend**. Me përjashtim të rasteve kur kompania ka **para të gatshme të mjaftueshme** në dispozicion të biznesit dhe mund të paguajë dividend, ajo që presin aksionarët është e gabuar.
- (b) Punonjësit mund të mendojnë se në rast se kompania bën fitime, ajo mund të përballojë **pagesën e pagave më të larta** vitin tjetër. Ky mendim mund të mos jetë i saktë: aftësia për të paguar varet nga **disponueshmëria e parasë së gatshme**.
- (c) Mbijetesa e një entiteti afarist nuk varet edhe aq shumë nga fitimet se sa **nga aftësia e tij për të paguar borgjet në kohën kur atyre iu vjen data e pagesës**. Pagesa të tilla mund të përfshijnë zëra të 'fitimit dhe humbjes' të tillë si blerjet e materialeve, pagat ineresin dhe tatimin etj., por njëkohësisht pagesat kapitale për pasuri të reja fikse dhe ripagimin e kapitalit kreditor kur atyre iu vjen koha për t'u paguar (për shembull riblerjen e obligacioneve).

Prej këtyre shembujve, mund të jetë e dukshme se performanca dhe përparimi i kompanisë varet jo aq shumë nga 'fitimet' e realizuara gjatë periudhës, por për të qenë më realist nga likuiditeti ose **rrjedhjet e arkës**.

SNK 7 kërkon që pasqyra e rrjedhjeve të arkës t'i raportojë rrjedhjet e arkës gjatë periudhës duke i klasifikuar si prej **aktiviteteve operacionale, investuese dhe të financimit**. Mënyra e paraqitjes së

⁶ Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit – SNK/IAS. f. 47-62

rrjedhjeve të arkës nga këto tre aktivitete **varet nga natyra e entitetit**. Duke i klasifikuar rrjedhjet e arkës nëpër aktivitete të ndryshme, në këtë mënyrë përdoruesit mund të shohin ndikimin e parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj mbi secilin lloj të aktiviteteve, dhe marrëdhënjet e tyre me njëra tjetrën.

5.1. Aktivitetet operacionale

Kjo është mbase pjesa kyçe e pasqyrës së rrjedhjeve të arkës për arsye se ajo tregon nëse, dhe në qfarë mase, kompanitë janë të afta të **gjenerojnë para të gatshme prej operacioneve të tyre**. Janë këto rrjedhje operacionale të arkës të cilat duhet, në fund të fundit të paguajnë për të gjitha daljet e parave të gatshme prej aktiviteteve të tjera, prapagesat e interesit të kredive, dividendët dhe kështu me radhë.

Shumica e përbërësve të rrjedhjeve të arkës prej aktiviteteve operacionale do të jenë ato zëra të cilët **përcaktojnë fitimin neto ose humbjen neto të entitetit**, pra ato kanë të bëjnë me aktivitete kryesore që gjenerojnë të hyra në entitet. Standardi jep elementët e mëposhtëm si shembuj tipi të rrjedhjeve të arkës prej aktiviteteve operacionale:⁷

- (a) Arkëtimet e parasë së gatshme prej shitjes së mallrave dhe kryerjes së shërbimeve,
- (b) Arkëtimet e parasë së gatshme prej dhënjes së të drejtave, tarifave, komisioneve (përqindjeve) dhe të hyrave tjera,
- (c) Pagesat në para të gatshme ndaj furnitorëve për mallra dhe shërbime,
- (d) Pagesat në para të gatshme tek dhe në emer të punëmarrësve.

5.2. Aktivitetet investuese

Rrjedhajt e arkës të klasifikuara sipas këtij tiulli tregojnë nëse sa investime janë bërë në **pasuri të cilat do të shërbejnë për të gjenuar fitime dhe rrjedhje të arkës në të ardhmen**. Standardi jep shembujt e mëposhtëm të rrjedhjave të arkës që vijnë si rezultat i aktiviteteve investuese:⁸

- (a) Pagesat në para të gatshme për të përfutur (blerë) pasuri të patundshme, impiante prodhimi dhe pajisje, pasuri të patrupëzuar dhe pasuri të tjera jo-qarkulluese, përfshirë këtu ato që kanë të bëjnë me kostot e kapitalizuara të zhvillimit dhe pasuritë e patundshme, impiantet e prodhimit dhe pajisjet e ndërtuara vetë,
- (b) Arkëtimet e parasë së gatshme prej shitjes së pasurive të patundshme, impinateve të prodhimit dhe pajisjeve, pasurive të patrupëzuara dhe pasurive tjera jo-qarkulluese,
- (c) Pagesat në para të gatshme për të përfutur (blerë) aksione ose obligacione të entiteteve tjera,
- (d) Arkëtimet e parasë së gatshme prej shitjes së aksioneve ose obligacioneve të entiteteve tjera,
- (e) Avancat në para të gatshme dhe kreditë e mundësuar ndaj palëve të treat,
- (f) Arkëtimet e parasë së gatshme prej ripagimit të avancave dhe kredive të mundësuar ndaj palëve të treat.

⁷ Horngren Charles, Harrison Walter, Smith Bamber Linda; *Accounting*, Fifth Edition, 2002. f. 92-118

⁸ Helfert, Erich A.; *Financial Analysis-Tools and Techniques*, 2001.

5.3. Aktivitetet e financimit

Ky seksion i pasqyrës së rrjedhjeve të arkës tregon atë pjesë të parave të gatshme e cila është pretenduar nga dhënësit e kapitalit të entitetit gjatë periudhës. Kjo është një tregues i **pagesave të ardhshme për inters dhe dividend**. Standardi jep shembujt e mëposhtëm të rrjedhjeve të arkës të cilët mund të përmbliken nën këtë titull:

- (a) Paratë e gatshme të marra prej emetimit të aksioneve,
- (b) Pagesat në para të gatshme ndaj pronarëve për të blerë ose rimbledhur aksionet e entitetit,
- (c) Paratë e gatshme të marra prej marrjes së kredive, emetimit të obligacioneve, dëftesave, bonove, marrjes së kredive hipotekare dhe huave të tjera afatshkurtra ose afatgjata,
- (d) Pagesat e parasë së gatshme për shumat e marra hua.

PASQYRA E RRJEDHËS SË ARKËS

01.01.2010 - 31.12.2010

AKTIVITETI OPERATIV	
<u>HYRJET</u>	
TË HYRAT	547 837
LLOGARITË E ARKËTUESHME	(232 350)
TË HYRAT NGA DIVIDENDA	20 164
HYRJET NGA AKTIVITETI OPERATIV	335 651
<u>DALJET</u>	
KMSH	10 033
STOQET	88 520
LLOGARITË E PAGUESHME	1 209
PASURIA RROTULLUESE	900
SHPENZIMET OPERATIVE	499 229
TATIMI NË FITIM I PAGUSHËM	11 748
DALJET NGA AKTIVITETI OPERATIV	611 639
RRJEDHA E ARKËS NGA AKTIVITETI OPERATIV	(275 988)
AKTIVITETI INVESTUES	
<u>HYRJET</u>	
HYRJET NGA AKTIVITETI INVESTUES	0
<u>DALJET</u>	
BLERJET E MJETEVE THEMELORE	1 335 149
DALJET NGA AKTIVITETI INVESTUES	1 335 149
RRJEDHA E ARKËS NGA AKTIVITETI INVESTUES	(1 335 149)
AKTIVITETI FINANCUES	
<u>HYRJET</u>	
REZERVAT	1 682 522
HYRJET NGA AKTIVITETI FINANCUES	1 682 522
<u>DALJET</u>	
DALJET NGA AKTIVITETI FINANCUES	0
RRJEDHA E ARKËS NGA AKTIVITETI FINANCUES	1 682 522
RRITJA / ZVOGLIMI I PARASË	71 385
PARAJA NË FILLIM	1 803
PARAJA NË FUND	73 88

6. Treguesit e pasqyrave financiare

Situata financiare identifikohet përmes raporteve financiare apo treguesve të cilët klasifikohen në disa grupe:⁹

1. Raportet e likuiditetit;
2. Raportet e menaxhimit të mjeteve apo të aktivitetit;
3. Raportet e borxhit;
4. Raportet e rentabilitetit (profitabilitetit).

6.1. Raportet e likuiditetit – tregojnë se a mundet ndërmarrja të përballoj detyrimet rrjedhëse (afatshkurta) të saj, kur u vjen afati i shlyerjes. Janë dy forma të matjes së raportit të likuiditetit:

a) **Raporti korrent dhe**

b) **Raporti i shpejtë (prova acide)**

- a) **Raporti korrent** – është raporti i mjeteve rrjedhëse dhe tregon se sa mirë janë mbuluar detyrimet afatshkurta të cilat duhet të shlyhen brenda vitit.

$$\text{Raporti korrent} = \frac{\text{MjetetRrje dhese}}{\text{DetyrimetAfatshkurta}}$$

Viti 2009:

$$\text{Raporti korrent} = \frac{781848}{50000} = 15.63 \text{ herë}$$

Viti 2010:

$$\text{Raporti korrent} = \frac{1175003}{48791} = 24.08 \text{ herë}$$

Ky raport tregon që për çdo euro që ndërmarrja duhet të paguaj brenda vitit 2009 ka 15.63 euro të cilat mund të jenë të holla ose do të shëndrrohen në para gjatë këtij viti, ndërsa në vitit 2010 kjo vlerë u rrit në 24.08 euro.

- b) **Raporti i shpejtë** – kalkulohet duke zvogëluar mjetet rrjedhëse për shumën e stoqeve dhe duke i pjesëtuar ato me detyrimet afatshkurta.

$$\text{Raporti i shpejtë} = \frac{\text{MjetetRrje dhese} - \text{Stoqet}}{\text{DetyrimetAfatshkurta}}$$

Viti 2009:

$$\text{Raporti i shpejtë} = \frac{781848 - 71480}{50000} = 14.21 \text{ herë}$$

Viti 2010:

$$\text{Raporti i shpejtë} = \frac{1175003 - 160000}{48791} = 20.80 \text{ herë}$$

Nga kjo shihet se ndërmarrja nuk ka probleme në mbulimin e detyrimeve afatshkurta, pa përfshirë stoqet, sepse ndërmarrja ka mbi një mjet (aset) për një detyrim.

⁹ Helfert, Erich A.; *Financial Analysis-Tools and Techniques*, 2001. f. 73-89

6.2. Raportet e menaxhimit të mjeteve apo të aktivitetit – matin se me çfarë efektiviteti menaxhohen mjetet në ndërmarrje.

6.2.1. Raportet e Qarkullimit – janë tregues të shpejtësisë së kthimit në para të mjeteve të ndërmarrjes.

$$\text{Qarkullimi i stoqeve} = \frac{\text{Shitjet}}{\text{Stoqet}}$$

Viti 2009:

$$\text{Qarkullimi i stoqeve} = \frac{328850}{71480} = 4.6 \text{ herë}$$

Viti 2010:

$$\text{Qarkullimi i stoqeve} = \frac{568001}{160000} = 3.55 \text{ herë}$$

Kjo tregon se ndërmarrja gjatë vitit 2009 i qarkullon 4.6 herë stoqet ndërsa gjatë vitit 2010 i qarkullon 3.55 herë stoqet.

6.2.2 Raporti i kthimit nga mjete neto – mat efektivitetin e përdorimit të mjeteve për të gjeneruar shitjet.

$$\text{Qarkullimi i mjeteve neto} = \frac{\text{Shitjet}}{\text{Mjetet} - \text{DetyrimetAfatshkurta}}$$

Viti 2009:

$$\text{Qarkullimi i mjeteve neto} = \frac{328850}{2638759 - 50000} = 0.13 \text{ herë}$$

Viti 2010:

$$\text{Qarkullimi i mjeteve neto} = \frac{568001}{4367063 - 48791} = 0.13 \text{ herë}$$

6.2.3. Raporti i qarkullimit të aktiviteve të qëndrueshme – mat se me çfarë efektiviteti përdorë ndërmarrja pajisjet dhe ndërtesat e saj.

$$\text{Qarkullimi i mjeteve fikse} = \frac{\text{Shitjet}}{\text{MjetetFikseNeto}}$$

Viti 2009:

$$\text{Qarkullimi i mjeteve fikse} = \frac{328850}{1856911} = 0.18 \text{ herë}$$

Viti 2010:

$$\text{Qarkullimi i mjeteve fikse} = \frac{568001}{3192060} = 0.18 \text{ herë}$$

6.2.4. Raporti i qarkullimit të mjeteve totale – mat qarkullimin e të gjitha mjeteve të ndërmarrjes dhe tregon se sa mban mjete për çdo euro të gjeneruar si arkëtim.

$$\text{Qarkullimi total i mjeteve} = \frac{\text{Shitjet}}{\text{MjetetTotale}}$$

Viti 2009:

$$\text{Qarkullimi total i mjeteve} = \frac{328850}{2638759} = 0.12 \text{ herë}$$

Viti 2010:

$$\text{Qarkullimi total i mjeteve} = \frac{568001}{4367063} = 0.13 \text{ herë}$$

Ky raport tregon se sa euro (vlerë) krijon ndërmarrja në bazë të mjeteve të saj të cilat i shfrytëzon në procesin e punës për vitin 2009 dhe për vitin 2010.

6.3. Raportet e borxhit – matin përdorimin e borxhit financiar nga ndërmarrja. Këto raporte tregojnë se si ka operuar ndërmarrja me përdorimin e borxhit si burim të financimit, si në raport me burimet e tjera ashtu edhe me riskun.

$$\text{Norma e borxhit} = \frac{\text{BorxhiTotal}}{\text{MjetetTotale}}$$

Viti 2009:

$$\text{Norma e borxhit} = \frac{50000}{2638759} = 0.0189 = 1.89 \%$$

Viti 2010:

$$\text{Norma e borxhit} = \frac{48791}{4367063} = 0.0112 = 1.12 \%$$

Ky raport tregon se 1.89 % e mjeteve totale të ndërmarrjes në vitin 2009 i takojnë borxhit, ndërsa në vitin 2010 ka rënë në 1.12 % e mjeteve totale.

6.4. Raportet e Rentabilitetit (Profitabilitetit) – matin efektet e kombinuara të likuiditetit, menaxhimit të mjeteve dhe borxhit në rezultatin e ndërmarrjes. Këto raporte shprehin saktësisht atë ç'far ndërmarrja fiton mbi shitjet e saj, mbi mjete ose mbi kapitalin.

a) Profiti marginal bruto – tregon përqindjen e fituar nga të ardhurat e shitjes pasi që malli ka arritur tek konsumatori.

$$\text{Profiti marginal bruto} = \frac{\text{FitimiBruto}}{\text{Shitjet}}$$

Viti 2009:

$$\text{Profiti marginal bruto} = \frac{320850}{328850} = 97.56 \%$$

Viti 2010:

$$\text{Profiti marginal bruto} = \frac{557968}{568001} = 98.23 \%$$

Nga kjo shihet se ndërmarrja jonë ka një profit marginal bruto shumë të lartë i cili vjen duke u rritur nga 97.56 % sa ishte në vitin 2009 në 98.23 % në vitin 2010. Kjo normë e lartë marginale e profitit bruto i siguron ndërmarrjes një pozitë më të mirë financiare.

b) Profiti marginal neto – tregon eurot e fituara nga shitja dhe fitohet duke pjesëtuar të ardhurat neto me shitjet .

$$\text{Profiti margjinal neto} = \frac{\text{FitimiNeto}}{\text{Shitjet}}$$

Viti 2009:

$$\text{Profiti margjinal neto} = \frac{(129438)}{328850} = (39.36) \%$$

Viti 2010:

$$\text{Profiti margjinal neto} = \frac{46991}{568001} = 8.27 \%$$

Në vitin 2009 ndërmarrja ka pasur një humbje prej 39.36 % , ndërsa në vitin 2010 ndërmarrja ka arritur që të ketë një fitim neto në fund të vitit prej 8.27 %.

7. Konkluzion

- Analiza e pasqyrave financiare është një proces shumë i rëndësishëm, madje edhe i domsodoshëm në marrjen e vendime të drejta. Arsyeja kryesore e realizimit së një analize financiare është zgjerimi i njohurive dhe shtimi i mundësive në marrjen e vendimeve të rëndësishme afariste.
- Informatat të cilat i ofron analiza financiare bashkë me kontabilitetin janë bazë për vendimet si brenda ashtu edhe jashtë ndërmarrjes.
- Nga analizat që i bëhen pasqyrave financiare të një ndërmarrje të caktuar mund të konstatojmë gjendjen financiare të saj, si ka operuar ajo gjatë periudhës për të cilën bëhet analiza, si dhe cilat janë trendet për të ardhmen në atë ndërmarrje.
- Ndërmarrjet janë të obliguara që të bëjnë përpilimin e pasqyrave financiare në harmoni me Standardet Kombëtare, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe/apo Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.
- Përgjegjësi në përgaditjen e pasyrave financiare në një ndërmarrje e kanë menaxhemti i ndërmarrjes.

Referencat

- Ahmeti, Skënder. (2007) *Kontabiliteti Financiar*, (pjesa e parë), Prishtinë.
- Ahmeti, Skënder. (2007) *Kontabiliteti Financiar*, (pjesa e dytë), Prishtinë.
- Ahmeti, Skënder. (2008) *Kontabiliteti i Menaxhmentit*, Prishtinë.
- Dhamo, Sotiraq. (2000) *Kontabiliteti Financiar*, Tiranë.
- Gorani, Hajrullah. (2008) *Fjalor Kontabiliteti*, Prishtinë.
- Horngren Charles, HarrisonWalter, Smith Bamber Linda. (2002) *Accounting*, Fifth Edition.
- Iseni, Etem. (2010) *Bazat e Kontabilitetit*, Tetovë.
- Ismajli, Hysen. (2002) *Qeverisaja Financiare*, Prishtinë.
- Instituti i Modelimeve në Biznes. (2007) *Kontabiliteti & Analiza Financiare*, Tiranë.
- Karapici, Vjollca. (2002) *Analiza Financiare*, Tiranë.
- Lewis, Richard & Pendrill David. (2004) *Advanced Financial Accounting*, seventh edition.
- Lumshi, Klevis. (2000) *Bazat e Kontabilitetit*, Tiranë.
- Mustafa, Isa. (2005) *Menaxhmenti Financiar*, Prishtinë.
- Shuli, Ingrid & Perri, Rezarta. (2008) *Analiza e Pasqyrave Financiare*, Tiranë.
- Xhafa, Halit. (2005) *Analiza e Pasqyrave Financiare*, Tiranë.
- Standardet e Kontabilitetit të Kosovës. (2011) – SKK. Prishtinë.
- Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit. (2011) – SNK/IAS.
- Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (2011) – SNRF/IFRS.
- SKK. (2008) Raporti financiar i kompanive të sigurimit, Prishtinë.